



## European Integration Summer School

Rr. Elbasanit, Nd.10, H.5

TIRANË, ALBANIA

TEL: (+355) 0672020197

E-mail: [info@go-albania.org](mailto:info@go-albania.org)

Web: [www.go-albania.org](http://www.go-albania.org)

**Objektivi:** Per te zhvilluar njohuri, sjellje dhe aftësi te të rinjtë në Shqipëri e rajon, duke i'u dhënë mundësinë atyre për të kuptuar rëndësinë e Integritimit European dhe implementimit të ligjeve të Bashkimit European.

**Periudha:** 1 -5 Gusht 2012

**Vend organizimi:** Tiranë, Shqipëri

**Donor:** Hanns Seidel Foundation

**Pjesëmarrësit:** Jo më shumë se 50 pjesëmarrës

**Aplikimet:** deadline 10 Korrik 2012

**Kontakt:** Znj. Joniada Hito ([joniada.hito@go-albania.org](mailto:joniada.hito@go-albania.org)); Z. Gjergj Xhafa ( [gjxhafa@gmail.com](mailto:gjxhafa@gmail.com) )

### APLIKIMI 2012

European Integration Summer School (EISS) është një projekt themeluar për të zhvilluar vizionin dhe zgjeruar njohuritë mbi Integritimin European, të individëve që duan të jenë gjithmonë një hap përpara që kur nesër të jemi ne Europë të gjendemi të përgatitur ndaj cdo sfile të mundëshme.

EISS 2012 ka për qëllim te zgjerojë njohuritë e studentëve te ekonomikut, drejtësisë dhe shkencave te tjera me bazat e procesit te integritimit ekonomik ne Europe (duke u fokusuar ne Shqipëri dhe vendet e Ballkanit), dhe të spikasi avantaxhet dhe sfidat e integritimit ekonomik në jetën e përditëshme.

Ky kurs do të përmbajë leksione, punë në grupe, dhe një detyrë për tu përmbushur në grup me ndihmën e supervizorëve të kursit. EISS do i ofrojë studenteve njohuri empirike të përditesuara dhe modele të reja analitike ekonomike, politike dhe sociale të integritimit European.

Anëtarët e Bordit Drejtues dhe lektorët e EISS janë ekspertë të shquar dhe aktivë, me kontribut të spikatur, të cilët

do të bejnë përzgjedhjen e kandidatëve që do të aplikojnë si dhe do të zhvillojnë leksionet e programit të parashikuar.

## **QËLLIMI I PROCESIT TË PËRZGJEDHJES**

Procesi i përzgjedhjes ka për qëllim të identifikojë kandidatët me cilësi më të lartë. Është qëllim i EISS të shprehë një preferencë të fortë për studentë të talentuar dhe me dëshirë për tu integruar në shoqërinë Europiane.

EISS do të mundësojë kryerjen e një cikli të plotë teorik dhe praktik duke u dhënë informacion mbi:

- Historiku dhe Institucionet e BE;
- Politikat mbizotëruese të integrimit të BE;
- Çështjet aktualë të BE;
- Sfidat e procesit të zgjerimit të BE;
- Një analizë e të gjithë kulturave brenda BE;
- Ekonomitë e BE dhe pesha që do të kenë me zgjerimin e BE;
- Çështjet ligjore të BE;
- Si Administrata Publike në vëndet tona është duke punuar për të marrë një linjë të plotë me ligjet e BE në procesin e zgjerimit;

EISS pret nga çdo pjesëmarrës të përmbushë këto angazhime:

1. Të marrë pjesë në të gjitha klasat (leksionet) dhe të plotësojë të gjitha detyrat që kërkohen;
2. Të përfshihet drejtëpërdrejtë dhe aktivisht në diskutime, për çështje të ndryshme që shtrohen për diskutim gjatë implementimit të programit akademik;

## **AFATI I FUNDIT PËR PRANIMET E APLIKIMEVE DHE KOSTOJA SHKOLLIMIT:**

**Afati përfundimtar i pranimit të aplikimit është data 10 Korrik 2012.**

Numri i aplikantëve që do të pranohen është i kufizuar për të garantuar cilësinë e mësimdhënies si dhe për të siguruar përvojë dhe mundësi të jashtëzakonshme për studentët.

**Pjesëmarrja në EISS është Falas.**

Nga organizatorët e këtij projekti është menduar që studentët të mos paguajnë për studimet dhe dijet e përfituara në EISS, duke synuar stimulimin dhe nxitjen e të rinjve të talentuar për t'u njohur me etapat drejt Integritimit Europian PA ASNJË PENGESË.

Financimi i EISS bëhet nga **Fondacioni "Hanns Seidel"**.

## **UDHEZIME PËR APLIKANTËT**

Ju lutem lexoni me kujdes informacionin lidhur me EISS, duke patur parasysh kritere e përzgjedhjes, programin dhe kohën e implementimit, si dhe kushtet për pjesëmarrje nese perzgjidheni.

### **Lexoni të gjithë aplikimin para se të filloni të shkruani.**

Plotësoni të gjitha rubrikat e aplikimit dhe dërgojeni në mënyrë elektronike. Mbani një kopje te kërkesës (aplikimit) tuaj për dosien tuaj personale.

### **Aplikimi dhe kriteret e përzgjedhjes**

Aplikantët për EISS duhet të plotësojnë këtë formular aplikimi duke deklaruar të dhënat e tyre personale dhe motivimin e interesit së bashku me pritshmëritë e tyre pas përfundimit të studimeve në EISS.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Bordi Drejtues në vlerësim të hollësishëm të formularit të aplikimit si dhe vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të formimit dhe përshtatjes individuale.

Ju do të njiheni me pranimin e aplikimit tuaj sapo të merret vendim. Komisioni përzgjedhjes do të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe do të identifikojë kandidatët në bazë të informacionit në formularin e aplikimit, përvojës, background-it/ kualifikimit si dhe përputhshmërisë me kriteret e kërkuara.

### **Nëpërmjet të dhënave të kontaktit që deklarohen në këtë formular, EISS do të njoftojë secilin kandidat për pranimin ose mospranimin e tij/ saj.**

Të gjithë aplikantëve të përzgjedhur si pjesëmarrës në EISS do ju kërkohet të marrin pjesë në të gjitha leksionet. Vetëm në këtë mënyrë do të pajisen me çertifikatën e diplomimit.

Pjesëmarrësit në EISS që do të humbin një apo më shumë leksione, do të kërkohet të zhvillojnë këto leksione brenda përfundimit të programit.

EISS përcakton (njeh) si mungesë: a) të papranishëm në leksion/ mospjesëmarrje në një leksion; b) vonesë në tridhjetë (30) minuta apo më shumë gjatë çdo leksioni, duke përfshirë këtu vonesën para ose pas një pushimi (break), dhe/ ose të largohen nga klasa tridhjetë (30) minuta ose më shumë gjatë leksionit, apo përfundimit të orarit të përcaktuar të leksionit.

Tre (1) mungese do të shkaktojnë përjashtimin nga EISS. Parimi i frekuentimit të vazhdueshëm të EISS, presupozon që studenti të qëndrojë në klasë në mënyrë korrekte. Lëvizjet e paarsyeshme dhe pa kriter përbëjnë thyerje të disiplinës së një ore mësimi pasi shkaktojnë shpërqëndrim të studentëve të pranishëm dhe të lektorëve.

Studentëve të cilët kryejnë mungesa gjatë zhvillimit të leksioneve, do t'u njihen si të justifikuar në rastet kur: a) mungesat e tyre janë për shkaqe të planifikuara rregullisht me vendim të Bordit, dhe b) studentët kanë bërë një

marrëveshje me parë me drejtuesit e EISS.

Studenti duhet të ketë parasysh numrin minimal të mungesave, në mënyrë që të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet e akademisë.

*Një student mund të përjashtohet nga EISS për qëndrim apo sjellje të pahijshme, për thyerje të etikës si dhe kur nuk i përmbahet rregullave dhe objektivave të vendosura të cilat i janë bërë të njohura më parë.*

*Përjashtimi i një studenti vendoset nga Bordi Drejtues. Studenti njihet në kohë me arsyet e përjashtimit dhe gëzon të drejtën të shfaqë pikëpamjet personale mbi procedurën dhe motivin e përjashtimit.*



## FORMULARI APLIKIMIT

Nr. i kandidatit \_\_\_\_\_

### INFORMACION I PËRGJITSHËM:

#### 1. TË DHËNA PERSONALE

Emër Mbiemër: \_\_\_\_\_

Emri

Atësia

Mbiemri

Datëlindja \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Vendlindja (qyteti) \_\_\_\_\_ Vendbanimi \_\_\_\_\_

Mashkull  Femër

Gjendja civile  i/e Martuar  x Beqar/e

Adresa: \_\_\_\_\_

Celular: \_\_\_\_\_ Tel fix: \_\_\_\_\_

E-Mail 1: \_\_\_\_\_ E-Mail 2: \_\_\_\_\_

## **EDUKIMI:**

### **2. TË DHËNA PËR STUDIMET E MËPARSHME**

Ju lutemi shënoni në rend kronologjik, nisur nga viti më i afërt, të gjitha studimet parauniversitare, universitare dhe pasuniversitare që keni kryer deri më sot.

<b>Emri i shkollës/ Universitetit</b>	<b>Qyteti/ shteti</b>	<b>Dega</b>	<b>Titulli i fituar nga diplomimi dhe/ ose specializimi</b>	<b>Nota mesatare</b>	<b>Periudha e studimeve/ diplomimit</b>

### **Kualifikime të tjera:**

## **EKSPERIENCA PROFESIONALE:**

### **3. TË DHËNA PËR PUNËSIMIN**

Institucioni/vendi i punës: \_\_\_\_\_

Pozicioni/detyra juaj: \_\_\_\_\_

Data e punësimit: (muaji/viti) \_\_\_\_\_ deri në \_\_\_\_\_

*Nëse keni punësime të tjera të mëparshme gjatë 5 viteve të fundit, ju lutem listoni ketu:*

1. \_\_\_\_\_

**Përshkruani shkurtimisht rolin dhe përgjegjësitë tuaja në pozicionin aktual. (50 fjalë ose më pak)**

**Cilat janë qëllimet për karrierën tuaj në pesë vitet e ardhshme. (50 fjalë ose më pak)**

### **4. AFTËSI PERSONALE**

#### **a) Zotërimi i gjuhëve të huaja**

*Shënoni nivelin e zotërimit të gjuhëve të tjera të huaja sipas shkallës (shumë mirë/ mirë/ mjaftueshëm/ dobët).*

1. \_\_\_\_\_

#### **b) Aftësi që i vlerësoni te vetja**

#### **c) Objektiv personal për të ardhmen**

## **6. MOTIVIMI, SFIDA PERSONALE DHE PRITSHMËRITË**

*Lexoni me kujdes pyetjet që vijojnë para se t'i përgjigjeni.*

- a) Shënoni motivet për të cilat ju dëshironi të ndiqni Akademinë Politike. (100 fjalë ose më pak)
- b) Çfarë prisni të përfitoni nga pjesëmarrja juaj në Akademinë Politike? (100 fjalë ose më pak)
- c) Bazuar në pritshmëritë e sipërpërmendura, tregoni sesi planifikoni të vini në veprim dijet dhe aftësitë e fituara nëpërmjet studimeve në këtë akademi? (100 fjalë ose më pak)
- e) Nga lista e mëposhtëme, zgjidhni tre sfidat më të rendësishme me të cilat përballet sot vendi ynë.

1. Punësimi
2. Mungesa e ujit dhe energjisë elektrike
3. Mjedisi dhe ndotja e ajrit
4. Infrastruktura dhe mirëmbajtja e rrugëve
5. Siguria publike
6. Cilësia e arsimit publik
7. Kujdesi shëndetsor
8. Ekonomia
9. Korrupsioni
10. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme

Përshkruaj shkurtimisht 1) pse ju besoni se secili prej tyre përbën një sfidë të madhe, dhe 2) a mendoni se me integrimin në BE keto ceshtje nuk do të jene me sfida. (100 fjalë ose më pak)

**Shënime të tjera**

**Plotësohet nga EISS: Aplikim i dorëzuar në:**

### **DEKLARATA E APLIKANTIT**

*Unë e kuptoj angazhimin tim për pjesëmarrje në European Integration Summer School, ndaj autorizoj me aprovimin dhe lejen time, të kontaktoni, konfirmoni apo të bëni çdo lloj kërkimi me qëllim vlerësimin e aplikimit tim dhe të përdorë informacionin që është dhënë në këtë aplikim për këtë qëllim. Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se i gjithë informacioni që kam dhënë në*

këtë formular dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet apo do i bashkëngjitet atij është i vërtetë dhe i plotë. Gjithashtu, vërtetohet se, të gjitha deklaratat e bëra në këtë aplikim janë korrekte dhe aktuale. Unë jam i/e vetëdijshëm/me se çdo shtrëmbërim (të dhëna të pasakta), informacion i pavërtetë ose pjesë e paplotësuar e këtij aplikimi, është një arsye e mjaftueshme për mohimin e të drejtës së pranimit dhe automatikisht do të më heqë të drejtën e studimit në EISS, nëse pavërtetësia do të zbulohet më vonë.

Marr përsipër të informoj Bordin Drejtues të EISS për çdo ndryshim të informacionit të dhënë prej meje, gjatë kohës që aplikimi im shqyrtohet apo gjatë pjesëmarrjes sime si student i EISS, nëse do të kem fituar të drejtën për të studjuar në të.

Unë e kuptoj se paraseleksionimi apo përzgjedhja e kandidatëve është përgjegjësi vetëm e Bordit Drejtues EISS dhe komisionit të ngritur enkas për këtë arsye. E kam lexuar dhe kuptuar informacionin që më është kërkuar të plotësoj.

EMËR MBIEMËR: \_\_\_\_\_ DATË: \_\_\_\_\_

Shënim: Një kopje e kësaj deklarate do të firmoset nga kandidati gjatë fazës së intervistimit.

### **Integrimi European Shkolle Verore**

**Rr. Elbasanit, Nd.10, H.5**

**TIRANË, ALBANIA**

**TEL: (+355) 0672020197**

**E-mail: [info@go-albania.org](mailto:info@go-albania.org)**

**Web: [www.go-albania.org](http://www.go-albania.org)**